REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 3729 **Prot** **Krumë me.** 16/10/**2025**

Drejtuar : MINISTRISË SË FINANCAVE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR
DREJTORISË SË HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

TIRANË

Lënda: Plani Strategjik dhe Vjetor i Auditimit të Brendshëm për periudhën 2026 – 2028, Bashkia Has

Në zbatim të nenit 14, gërma c e ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" të ndryshuar, dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka hartuar "Planin Strategjik dhe Vjetor të Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm për periudhën 2026 - 2028".
Bashkëlidhur ju dërgojmë relacionin për planin strategjik dhe vjetor si dhe formatet përkatëse.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR
Miftar DAUTI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

***Adresa**: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 3730 Prot

Krumë me. 16 / 10 /2025

MIRATOI
KRYETAR
Miftar DAUTI

PLANI STRATEGJIK DHE VJETOR PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM BASHKIA HAS VITI 2026 - 2028

- **Hyrje**

Për përgatitjen e Planit Vjetor dhe Strategjik të Auditimit të Brendshëm, Sektori i Auditimit të Brendshëm në Njësinë Vendore Bashkia Has, u mbështet në rregullat dhe kërkesat e shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Raportimit Financiar (Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm), me nr. 13111 prot, datë 10.09.2025, si dhe mbështetur në Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" të ndryshuar, Urdhëri i Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik" i ndryshuar.

Plani Strategjik për Njësinë e Auditimit të Brendshëm është një dokument i rëndësishëm që përshkruan objektivat, strategjitë dhe aktivitetet e planifikuara për të arritur një menaxhim efektiv të rreziqeve dhe përmirësimin e proceseve brenda institucionit.

I. QËLLIMI I PLANIT STRATEGJIK DHE MISIONI I NJAB

QËLLIMI I PLANIT STRATEGJIK

Qëllimi i Planit Strategjik të Auditimit është të sigurojë një kuadër të strukturuar për menaxhimin dhe drejtimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm brenda institucionit. Plani Strategjik ka për qëllim të programojë punën që do të ndërmerret nga struktura e Auditit të Brendshëm të Bashkisë Has për periudhën e ardhshme 3 vjeçare (1+2 vjet) 2026 – 2028.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

Në hartimin e planit strategjik të Bashkisë Has jemi mbështetur në njohjen e Bashkisë duke marrë në konsideratë rreziqet e përgjithshmë të auditimit, kuadrin ligjor dhe rregullator, performancën financiare dhe sistemet e kontrollit të brendshëm duke pasur parasysh në hartimin e tij që rreziku është gjithpërfshirës.

Në hartimin e planit strategjik në Bashkinë Has për periudhën 2026 – 2028 jemi mbështetur në plotësimin e formatit standard 3 dhe 4, si dhe në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) duke pasur parasysh frekuencën dhe kohëzgjatjen e auditimit, si dhe duke u fokusuar në elemenët e mëposhtme për secilin sektor që planifikohet ky angazhim auditimi.

- Rëndësia
- Ndryshimi
- Risku
- Pikëpamjet e menaxherëve.
- Ndikimi i jashtëm
- Frekuenca
- Materialiteti

Sektori i Auditimit të Brendshëm është konsultuar dhe ka rënë dakord me titullarin e institucionit, lidhur me problemet e kontrolleve të brendshme të administrimit si dhe ka synuar që të zbatojë në mënyrë efektive mbulimin e veprimtarive kryesore me risk më të lartë. Angazhimet e Auditimit të Brendshëm në Planin Strategjik janë vlerësuar mbi bazën e nevojave 3 (tre) vjeçare për auditime. Vlerësimi i nevojave të auditimit do të rishikohet çdo vit, në kohën kur do të hartohet Plani Vjetor i auditimit për vitin e ardhshëm, duke u siguruar që janë përfshirë të gjitha veprimtaritë e reja dhe ndryshimet e tjera të programeve.

Gjatë hartimit të Planit Vjetor dhe Strategjik 2026 - 2028 janë mbajtur parasysh dhe ndryshimet strukturore dhe organizimet e reja në drejtori dhe sektorë të Bashkisë Has si dhe rregullorja e re e bashkisë. Me implementimin e tyre Plani Vjetor dhe Plani Strategjik do të rishikohen për t'iu përshtatur nevojave aktuale të njësisë.

Në hartimin e këtij plani rëndësi i është kushtuar dhe porosive të dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Raportimit Financiar, Drejtoria e Harmonizmit të Auditimit të Brendshëm me shkresën Nr.13111 Prot., datë 10.09.2025 protokolluar me tonën me Nr. 3315 prot, datë 18.09.2025 "Mbi përgatitjen e Planit Strategjik dhe Vjetor të veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitet 2026 - 2028", si dhe shkresa me nr. 9729/27 prot, datë 18.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 2198 prot, datë 30.06.2025 "Mbi mangësitë e evidentuara në raportimin e Planit Strategjik dhe Vjetor të veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm për periudhën 2025 – 2027".

Në plotësimin e formatit standard nr.1, të planit strategjik të auditimit, jemi mbështetur në misionin e Bashkisë Has, mundësinë e risqeve për mosrealizim të objektivave të përcaktuara. Jemi munduar të fusim në program auditimi sisteme të cilat shihen, si ndikuesit kryesor në realizimin e misionit të Bashkisë Has, të përcaktojmë fushat që kërkojnë vëmendje të vecantë dhe të sigurojë qe burimet të përdoren në mënyrë efektive.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

Bashkia Has, në zhvillimin e veprimtarisë së tij është mbështetur në rregulloren e brendshme të miratuar nga titullari i bashkisë bazuar në Kushtetutën e RSH-së, ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", planifkimi strategjik, financimi, zhvillimi i kapaciteteve, ndarja e sektorëve dhe shërbimeve bashkiake sipas strukturës organizative e miratuar nga Titullari në bashkëpunim me drejtoritë dhe sektorët përkatës për arritjen e objektivave të Bashkisë.

- *MISIONI I NJAB*

Misioni i Njësisë së Auditimit të Brendshëm është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësisë publike në mënyrë të pavarur dhe objektive, këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik, Bashkia Has.

Auditimi i Brendshëm ndihmon Bashkinë Has të arrijë objektivat e veta, nëpërmjet vlerësimeve të pavarura mbi performancën e Bashkisë, rekomandimeve për përmirësimin e proceseve dhe praktikave të menaxhimit, sigurimi që informacionet financiare dhe operacionale janë të sakta dhe të besueshme si dhe inkurajimi i një kulture të përmirësimit të vazhdueshëm brenda institucionit.

II. ORGANIZIMI I NJAB DHE KUADRI LIGJOR

- *STRUKTURA E NJAB*

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Has është e planifikuar si Njësi, pjesë përbërëse e srukturës organizative të Bashkisë me strukturë organike të përbërë nga :

- 1 (një) Përgjegjës i Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe
- 2 (dy) specialistë Auditues të Brendshëm.

Struktura organike është e paplotësuar dhe nuk funksionon me personel të plotë pasi mungon Përgjegjësi i AB si dhe për 1 specialist vazhdojnë procedurat e çertefikimit si Auditues i Brendshëm, me qëllim fillimin e auditimeve sipas planit strategjik dhe vjetor.

- *KUADRI LIGJOR*

Njësia e Auditimit të Brendshëm Bashkia Has ushtron aktivitetin duke u bazuar kryesisht në zbatim të kuadrit ligjor si më poshtë:

- Ligji nr.114, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" (i ndryshuar);
- Urdhër nr.4, datë 10.01.2020 Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016;
- Urdhër nr. 103, Datë 23.07.2025 për "Miratimin e Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm të Pranuara për Zbatim në Sektorin Publik në Republikën e Shqipërisë";
- VKM Nr. 83, datë 3.2.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik" (I Ndryshuar)
- Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar;

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

- Praktikat Profesionale të publikuara nga Instituti i Audituesve të Brendshëm si dhe sipas subjekteve që auditohen në ligjet përkatës.

III. OBJEKTIVAT STRATEGJIK .

a) Vizionin dhe objektivat strategjikë të funksionit të auditimit të brendshëm;

Vizioni: Vizioni i Njësisë së Auditimit të Brendshëm është që vazhdimisht të ofrojë shërbime që i shtojnë vlerë dhe minimizojnë risqet nëpërmjet vlerësimit të veprimtarisë operacionale të Bashkisë Has, duke ndihmuar bashkinë të arrijë objektivat e saj strategjikë nëpërmjet përmirësimit të proceseve të qeverisjes, menaxhimit të riskut dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm. Vizioni arrihet duke aplikuar standardet globale të auditimit dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, si dhe duke përshtatur vazhdimisht qasjet dhe duke marrë iniciativa drejt përmirësimit të cilësisë.

Objektivat Strategjikë të Njësisë së Auditimit të Brendshëm janë:

- **Forcimi i pavarësisë dhe objektivitetit**
  - Garantimi i ushtrimit të funksionit të auditimit në përputhje me standardet ndërkombëtare të IIA dhe legjislacionin vendas.
  - Raportimi i drejtëpërdrejtë tek Kryetari i Bashkisë.

- **Rritja e efektivitetit të auditimit**
  - Hartimi dhe zbatimi i planeve vjetore të auditimit të bazuara në risk.
  - Përdorimi i metodologjive moderne për vlerësimin e riskut dhe kontrollit.

- **Shtimi i vlerës për institucionin**
  - Dhënia e rekomandimeve praktike dhe të zbatueshme për përmirësimin e proceseve operacionale dhe shërbimeve publike.
  - Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm të strukturave të audituara.

- **Mbështetja e menaxhimit të riskut dhe qeverisjes**
  - Këshillimi i menaxhimit për vendosjen e mekanizmave efektivë të menaxhimit të riskut.
  - Vlerësimi i qeverisjes institucionale për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.

- **Zhvillimi profesional i vazhdueshëm**
  - Trajnimi dhe certifikimi i audituesve të brendshëm.
  - Shfrytëzimi i teknologjisë dhe mjeteve IT për të rritur efikasitetin e punës së auditimit.

Adresa: *Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

b) **Identifikimin dhe analizën e pikave të forta**, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve të funksionit të auditimit të brendshëm (analiza SWOT), apo një analizë të kufizimit midis gjendjes aktuale dhe asaj të dëshiruar;

Analiza SWOT (Pikat e forta, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet) ndihmon në identifikimin e gjendjes aktuale të funksionit të auditimit të brendshëm dhe në përcaktimin e masave për përmirësimin e tij.

ANALIZA SWOT	
Pikat e forta (Strengths) - Staf i kualifikuar dhe i specializuar në fushën e auditimit të brendshëm. - Përvoja e mëparshme në auditime të sektorëve kryesorë të Bashkisë. - Standardizimi i procedurave dhe përdorimi i udhëzimeve dhe rregulloreve të brendshme. - Bashkëpunim i mirë me njësitë audituese dhe menaxhimin e Bashkisë.	**Dobësitë (Weaknesses)** - Burime njerëzore të kufizuara në Njësinë e Auditimit; - Përdorim i kufizuar i mjeteve IT; - Mungesë specializimi në fusha specifike; - Pjesëmarrje e kufizuar në rrjete profesionale të auditimit; - Niveli i ulët i ndërgjegjësimit të sektorëve të audituar për rëndësinë e auditimit dhe respektimin e rekomandimeve.
Mundësitë (Opportunities) - Rritja e kapaciteteve profesionale të audituesve përmes trajnimeve të ofruara nga Ministria e Financave, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) dhe organizata ndërkombëtare; - Integrimi i sistemeve elektronike dhe platformave për menaxhimin e dokumentacionit; - Përmirësimi i koordinimit me njësitë e tjera për të siguruar transparencë dhe gjurmueshmëri; - Mundësia për të rritur rolin këshillues të auditimit, duke dhënë rekomandime për përmirësimin e menaxhimit strategjik dhe operativ të bashkisë.	**Kërcënimet (Threats)** - Mungesa e burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe teknologjike për të kryer auditime të plota dhe në kohë; - Ndryshime të shpeshta në legjislacion; - Ndikime të mundshme politike; - Rezistencë në zbatimin e rekomandimeve; - Rreziqet e sigurisë së informacionit, përfshirë humbjen ose manipulimin e dokumenteve; - Ndërprerjet në financimin ose mbështetjen institucionale për funksionin e auditimit të brendshëm;

- **Analiza e Gjendjes së Funksionit të Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Has**

Gjendja aktuale: Funksioni i Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Has është i strukturuar dhe funksionon në përputhje me ligjin dhe rregulloret në fuqi.
Aktualisht, Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Has funksionon me vetëm 1 specialistë auditimi i brendshëm. Megjithëse stafi nuk është i çertifikuar, ata ndjekin rregullisht trajnime profesionale për zhvillimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e njohurive në fushën e auditimit.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

Njësia e Auditimit të Brendshëm zbaton planin vjetor të auditimit dhe kryen shqyrtime periodike të proceseve dhe procedurave të brendshme, duke synuar sigurimin e kontrollit dhe transparencës së veprimtarisë së njësive të Bashkisë.
Megjithatë, kapaciteti i kufizuar i stafit dhe mungesa e çertifikimeve formale kufizon potencialin për të realizuar auditime të thelluara dhe për të monitoruar në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e rekomandimeve. Bashkëpunimi me njësitë e tjera funksionon, por ekziston nevoja për forcim të procedurave të gjurmueshmërisë së dokumentacionit dhe raportimit.

Gjendja e dëshiruar: Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Has synon të zhvillohet në një funksion të plotë profesional, me staf të mjaftueshëm dhe të çertifikuar, i cili posedon njohuri të thelluara në auditimin financiar, auditimin e prokurimeve publike, kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e riskut.
Njësia e AB do të aplikojë standardet globale të auditimit dhe praktika më të mira në fushën e auditimit publik, duke siguruar planifikim strategjik, monitorim të vazhdueshëm të rekomandimeve, dhe raportim të qartë dhe të gjurmueshëm.
Gjithashtu, synohet zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme për specialistët e auditimit, për t'i mbajtur të përditësuar me legjislacionin, rregulloret dhe praktikat më të mira të auditimit, dhe për të garantuar një përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë dhe efektivitetit të veprimtarive të auditimit.
Niveli i avancuar profesional do të rrisë besueshmërinë e raportimit, do të forcojë kontrollin e brendshëm dhe do të kontribuojë në një qeverisje më transparente dhe të përgjegjshme në Bashkinë Has.

c) **Iniciativat dhe aktivitetet** që mbështesin objektivat strategjikë në përshtatje me objektivat strategjikë të Bashkisë Has

Iniciativat dhe aktivitetet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që të mbështesin drejtpërdrejt objektivat strategjikë të Bashkisë Has. Përmes auditimeve të planifikuara, monitorimit të rekomandimeve, zhvillimit profesional të stafit dhe përmirësimit të procesit të dokumentimit, Njësia e Auditimit të Brendshëm synon të forcojë menaxhimin e risqeve, të rrisë transparencën dhe të kontribuojë në vendimmarrje të informuar dhe efektive në të gjitha nivelet e administratës publike.
Për të arritur objektivat strategjikë të Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe për t'i përshtatur me objektivat strategjikë të Bashkisë Has, do të ndërmerren aktivitetet dhe iniciativat kryesore si më poshtë:

- **Zbatimi i Planit Vjetor të Auditimit** – Kryerja e auditimeve sipas planifikimit të miratuar, për të siguruar mbikëqyrje efektive të proceseve dhe riskut në njësitë e audituara.
- **Monitorimi i rekomandimeve të auditimit** – Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve dhe kontrollit të brendshëm.
- **Zhvillimi profesional i stafit të auditimit** – Pjesëmarrja në trajnimet profesionale, seminaret dhe aktivitetet e certifikimit, për të rritur kapacitetet dhe aftësitë e stafit.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

- **Standardizimi dhe gjurmueshmëria e dokumentacionit** – Hartimi dhe zbatimi i procedurave të brendshme për administrimin e dokumentacionit të auditimit, duke garantuar qartësi, gjurmueshmëri dhe përputhje me rregulloret në fuqi.
- **Bashkëpunimi ndërsektorial** – Forcimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me njësitë e tjera të Bashkisë, për të siguruar mbështetje efektive të veprimtarive të auditimit dhe për të përmirësuar cilësinë e raportimit.
- **Përmirësimi i raporteve dhe komunikimit të rezultateve** – Përgatitja e raporteve të qarta, të detajuara dhe të kuptueshme për menaxhimin e njësisë, duke kontribuar në transparencën dhe llogaridhënien institucionale.

d) **Përshtatjen e strategjisë në rast të ndryshimeve** në: objektivat strategjikë dhe strategjinë e organizatës, politikat dhe procedurat e organizatës, menaxhimin e rrezikut dhe kontrollit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm do të kryejë rishikime periodike të strategjisë së vet për të siguruar që ajo të mbetet e përshtatshme dhe efektive në çdo kohë. Kjo përfshin përshtatjen e strategjisë në rast të ndryshimeve në:

- Objektivat strategjikë dhe strategjinë e përgjithshme të organizatës;
- Politikat dhe procedurat e brendshme të Bashkisë Has;
- Menaxhimin e rrezikut dhe sistemet e kontrollit të brendshëm.

Kjo qasje siguron që veprimtaritë e auditimit të jenë gjithmonë të përputhshme me prioritetet e Bashkisë dhe të kontribuojnë në arritjen e objektivave institucionale.

- Metodologjia për Zbatimin e Strategjisë dhe Realizimin e Planit të Auditimit të Brendshëm (2026 – 2028)

Për të udhëhequr funksionin e auditimit të brendshëm dhe për të zbatuar strategjinë e auditimit për periudhën 2026 – 2028, NJAB, Bashkia Has do të mbështetetet në metodologji të qarta dhe të standardizuara, në përputhje me Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm.

1. Vlerësimi i rreziqeve për organizatën dhe për çdo angazhim

Plani strategjik i auditimit bazohet në një vlerësim gjithëpërfshirës të rrezikut në nivel organizativ. Ky vlerësim realizohet përmes:

- Analizës së objektivave strategjike dhe operacionale të institucionit,
- Intervistave me drejtuesit dhe menaxhmentin e njësive,
- Shqyrtimit të raporteve të mëparshme të auditimit dhe të gjetjeve të organeve të jashtme të kontrollit,
- Përdorimit të një matrice rreziku që vlerëson ndikimin dhe probabilitetin e çdo rreziku.

Për çdo angazhim individual të auditimit, NJAB do të kryejë një vlerësim të rrezikut specifik, i cili do të udhëheqë qëllimet dhe fushëveprimin e angazhimit.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

2. Zhvillimi dhe përditësimi i planit të auditimit të brendshëm

Plani strategjik dhe ai vjetor do të:

- Ndërtohen mbi bazën e vlerësimit të rreziqeve për të siguruar fokusin në fushat me rëndësi të lartë për Bashkinë,
- Rishikohen dhe përditësohen periodikisht për të reflektuar ndryshimet në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm,
- Përfshijnë auditime që i japin përparësi fushave që mbartin rreziqe të larta, ndikim të rëndësishëm në shërbimet publike dhe/ose kanë qenë më parë subjekt i gjetjeve kritike.

3. Përcaktimi i ekuilibrit ndërmjet angazhimeve të sigurimit dhe këshillimit

Gjatë periudhës 2026 – 2028, NJAB do të synojë një ekuilibër optimal ndërmjet auditimeve të sigurimit dhe angazhimeve këshilluese, në mënyrë që të:

- Sigurojë përputhshmëri, integritet dhe efikasitet të proceseve organizative perms auditimeve të sigurimit;
- Mbështesë menaxhmentin me këshillim profesional në përmirësimin e kontrolleve dhe procesit vendimmarrës, pa cënuar pavarësinë e auditimit;
- Raportojë veçmas për të dy llojet e angazhimeve, duke identifikuar burimet dhe rezultatet për secilin.

Ky balancim do të përcaktohet çdo vit në planin vjetor, sipas analizës së nevojave organizative dhe kapaciteteve të NJAB.

4. Koordinimi me ofruesit e brendshëm dhe të jashtëm të sigurisë

NJAB do të vazhdojë të forcojë koordinimin dhe bashkëpunimin me palët e tjera të linjës së dytë dhe të tretë të mbrojtjes, përfshirë:

- Kontrollin e brendshëm institucional;
- Audituesit e jashtëm si KLSH,

Ky bashkëpunim do të mundësohet përmes:

- Shkëmbimit të informacionit mbi rreziqet dhe gjetjet;
- Planifikimit të përbashkët të angazhimeve në rastet kur është e nevojshme;
- Koordinimit për të shmangur mbivendosjen dhe dyfishimin e punës.

Qëllimi është krijimi i një qasjeje të bashkërenduar dhe efikase për garantimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe qeverisjes së mirë.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

IV. IDENTIFIKIMI I SUBJEKTEVE .

Për periudhën 3 - vjeçare 2026 - 2028, auditimi në Bashkinë Has dhe njësitë vartëse do fokusohet në mbulimin me auditim të gjithë subjekteve të varësisë, gjë e cila do të realizohet në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm (i ndryshuar), miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016.

Për identifikimin e subjekteve që do auditohen do merren në konsideratë objektivat e subjektit, fondet buxhetore që kanë në përdorim subjektet e audituara, fushat e veprimtarisë së këtyre subjekteve, riskun që mbulojnë këto subjekte, numrin e punonjësve si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna.

Për periudhën 2026 - 2028 janë planifikuar gjithsej 15 (pesëmbëdhjetë) auditime sipas burimeve aktuale të Njësisë së Auditimit të Brendshëm, nga të cilat 5 (pesë) subjekte për 2026, 5 (pesë) subjekte në vitin 2027 dhe 5 (pesë) subjekte në vitin 2028.

Për vitin 2026 janë identifikuar për auditim 5 (pesë) subjekte si vijon:

1. Auditimi i ndjekjes së zbatimit të Rekomandimeve të NJAB;
2. Drejtoria e Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore (Detyrimet e Prapambetura);
3. Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore;
4. Sektori Juridik dhe Prokurimet Publike ;
5. Sektori i Planifikim Territorit dhe Urbanistikës.

Në planin e vitit 2027 janë planifikuar 5 subjekte auditimi, përkatësisht:

1. Auditimi i ndjekjes së zbatimit të Rekomandimeve të NJAB;
2. Drejtoria e Financës,Taksave dhe Tarifave Vendore (Detyrimet e Prapambetura);
3. Drejtoria e Administrimit të Pyjve;
4. Sektori i Zhvillimit Ekonomik;
5. Gjendja Civile.

Në planin e vitit 2028 janë planifikuar 5 subjekte auditimi, përkatësisht:

1. Auditimi i ndjekjes së zbatimit të Rekomandimeve të NJAB;
2. Drejtoria e Financës,Taksave dhe Tarifave Vendore (Detyrimet e Prapambetura);
3. Sektori Juridik dhe Prokurimet Publike;
4. Drejtoria e Mbrojtjes Civile ;
5. Sektori i Tokës/ Mbrojtjes Konsumatorit.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

e) IDENTIFIKIMI I FUSHAVE / SISTEMEVE PRIORITARE.

Plani Strategjik i Njësisë së Auditimit të Brendshëm për periudhën 2026 – 2028 do të orientohet drejt identifikimit dhe përfshirjes në auditim të fushave me risk potencial, si dhe të auditimeve të performancës, duke u fokusuar në:

- Fushat e qeverisjes dhe transparencës në njësinë publike;
- Komponentët kyç të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, të përcaktuar sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor për menaxhimin financiar dhe kontrollin, duke ndjekur Modelin COSO;
- Vlerësimin e riskut në procese dhe veprimtari të ndryshme;
- Pajtueshmërinë me rregullat dhe legjislacionin në fuqi;
- Performancën e njësisë publike në realizimin e objektivave të saj.

Ky fokus do të sigurojë që auditimet të jenë të drejtuara jo vetëm drejt përputhshmërisë dhe kontrollit financiar, por edhe drejt rritjes së efikasitetit, efektivitetit dhe transparencës në veprimtarinë e njësisë.

Njësia e Auditimit të Brendshëm mbulon me auditim 25 subjekte: ku 5 subjekte janë Drejtori, sektorë e inspektoriate të tjera në juridiksionin e Bashkisë Has, si Sektori i Edukimit dhe Shërbimeve në Konvikt, Arsimi Parashkollor + QKF, Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH), Administrimi i Pyjeve, Bordi i Kullimit, Gjendja Civile, si dhe 3 Njësi Administrative në juridiksionin e Bashkisë Has si: NJA Golaj, NJA Fajza, NJA Gjinaj.
Më poshtë paraqitet ndarja e Drejtorive dhe Sektorëve respektivë:

Bashkia sipas fushave:

Nr.	Sektori	Sistemet / Fushat Prioritare	Frekuenca e Auditimit	Vlerësimi i Riskut
1	**Drejtoria e Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore**	Sistemi i pagave; Sistemi i debitorëve; Sistemi i pagesave për mallra dhe shërbime; Sistemi kryesor i llogarisë; Sistemi i kontrollit të të ardhurave dhe shpenzimeve; Sistemi i sigurimit dhe menaxhimit të riskut; Sistemi i shpenzimeve të kapitalit; Sistemi i inventarit; Sistemi i menaxhimit të riskut; Sistemi i prokurimeve publike; Sistemi i menaxhimit buxhetor; Ruajtja e aseteve; Sistemi i kontabilitetit; Sistemi i pasqyrave financiare; Menaxhimi i buxhetit, arka, shpenzimet, Llogaritja e pagave dhe listë-pagesat; Kontabiliteti dhe pasqyrat financiare; Magazinimi dhe administrimi i inventarit	Çdo vit	I Lartë

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

2	**Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore**	Sistemi i Tarifa të Shërbimeve Publike Vendore; Sistemi i Arkëtimit të Detyrimeve; Sistemi i Raportimit Financiar dhe Monitorimit; Sistemi i Kadastrës Fiskale dhe Regjistrit të Taksapaguesve; Sistemi i Administrimit të Taksave mbi Aktivitetet Ekonomike;	1 herë në vit	I lartë
3	**Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore**	Sistemi i ndihmës ekonomike; Sistemi i Pagesës për Aftësi të Kufizuar (PAK); Sistemi i Strehimit; Sistemi i Përkujdesjes Shoqërore; Sistemi i Ankesave dhe Komunikimit me Qytetarët; Sistemi Financiar dhe Raportimi	5 vjet	I Ulët
4	**Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës**	Sistemi i Hartimit të Dokumentave të Territorit; Sistemi i Lëshimit të Lejeve të Ndërtimit; Sistemi i Monitorimit dhe Kontrollit të Zbatimit; Sistemi i Arkivimit të Dokumentacionit Teknik; Sistemi i Platformave Elektronike; Sistemi i administrimit të pronave; Sistemi i komunikimit me ASHK; Sistemi i të Dhënave; Sistemi i Adresave; Sistemi i Privatizimit	3 vjet	I Mesëm
5	**Sektori i Tokës/Mbrojtjes Konsumatorit**	Sistemi i regjistrimit dhe Administrimit të Tokës; Sistemi i Monitorimit dhe Kontrollit të Përdorimit të Tokës; Sistemi i Mbrojtjes së Tokës nga Erozioni dhe Degradimi;	5 vjet	I Ulët
6	**Sektori i Burimeve Njerëzore**	Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore; Sistemi i HRMIS dhe Administrata.al; Sistemi i Komunikimit me Median; Sistemi i Arkivës; Sistemi i IT	2 vjet	I Mesëm
7	**Sektori Juridik dhe Prokurimet Publike**	Sistemi i Sektorit Juridik; Sistemi i Prokurimeve Publike; Sistemi i Protokollit; Sistemi i Koordinimit Evropian dhe Ndihmës së Huaj; Sistemi i Migracionit dhe Diasporës	Çdo vit	I Lartë
8	**Sektori i Zhvillimit Ekonomik**	Sistemi i zhvillimit ekonomik; Sistemi i turizmit; Sistemi i projekteve; Sistemi për promovimin e qytetit	3 vjet	I Mesëm

***Adresa**: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al


9	**Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sportit**	Administrimi i shkollave dhe kopshteve; Sistemi i Inspektimit dhe Monitorimit të Arsimit; Sistemi i Menaxhimit të Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore; Biblioteka	3 vjet	I Ulët
10	**Sektori i Edukimi dhe Shërbimet në Konvikt**	Sistemi i Regjistrimit dhe Përfitimit të Shërbimit në Konvikt; Sistemi i Shërbimeve Ushqimore dhe Higjiena; Sistemi i Mirëmbajtjes dhe Infrastruktura; Sistemi i Aktiviteteve Edukative dhe Kujdesit Social	5 vjet	I Ulët
11	**Sektori i Turizmit dhe Sportit**	Sistemi i Zhvillimit dhe Promovimit të Turizmit; Sistemi i Mbrojtjes së Burimeve Turistike; Menaxhimi i Sportit dhe Infrastruktura Sportive	5 vjet	I Ulët
12	**Qendra Kulturore e Fëmijëve**	Sistemi i Regjistrimit dhe Përzgjedhjes së Fëmijëve; Sistemi i Kujdesit dhe Shërbimeve Edukative; Sistemi i Planifikimit dhe Organizimit të Aktiviteteve; Sistemi i Menaxhimit të të ardhurave dhe shpenzimeve; Sistemi i Administrimit të Infrastrukturës dhe Paisjeve	5 vjet	I ulët
13	**Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Komunale**	Shpenzimet për pastrimin, menaxhimi i punonjësve Mirëmbajtja e gjelbërimit, punonjësit sezonalë Menaxhimi i mbetjeve, transporti dhe shpenzimet Mirëmbajtja e objekteve, ndriçimi, riparimet	3 vjet	I Mesëm
14	**Sektori i Rrugëve / Kanalizimeve**	Sistemi i Ndërtimit, Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Rrugëve; Sistemi i Kanalizimeve	3 vjet	I Mesëm
15	**Sektori Bordi i Kullimit**	Sistemi i Menaxhimit të Ujërave dhe Shfrytëzimit; Sistemi Financiar dhe Tarifimi; Sistemi i Menaxhimit të Infrastrukturës së Kullimit Mirëmbajtja e kanaleve vaditëse dhe kulluese	3 vjet	I Mesëm
16	**Drejtoria e Mbrojtjes Civile**	Sistemi i Planifikimit të Emergjencave; Sistemi i Monitorimit dhe Sinjalizimit; Sistemi i Trajnimeve dhe Stërvitjeve; Sistemi i Dokumentimit dhe Raportimit; Sistemi i Bashkëpunimit Ndërinstitucional; Sistemi i Menaxhimit të Rezervave të Emergjencës;	3 vjet	I Mesëm
17	**Sektori i Emergjencave Civile**	Sistemi i Planifikimit dhe Parandalimit të Emergjencave; Sistemi i Monitorimit dhe Sinjalizimit të Rreziqeve; Sistemi i Reagimit dhe Menaxhimit të Emergjencave; Sistemi i Bashkëpunimit Ndërinstitucional; Sistemi i Përdorimit dhe Mirëmbajtjes së Pajisjeve të Emergjencës; Sistemi i Raportimit dhe Dokumentimit të Ngjarjeve	3 vjet	I Mesëm
18	**Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe**	Sistemi i Paisjeve, Mjeteve dhe Inventarit Teknik; Sistemi i Trajnimeve dhe Gatishmëria e stafit; Sistemi i furnizimit dhe buxheti për MZSH;	3 vjet	I Mesëm

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

	Shpëtimi	Sistemi i Bashkëpunimit dhe Komunikimi me institucione tjera		
19	**Policia Bashkiake**	Sistemi i Inspektimeve dhe Kontrolleve në Terren; Sistemi i Zbatimit të Masave Administrative; Sistemi i Menaxhimit të Ankesave dhe Koordinimi i tyre.	5 vjet	I Ulët
20	**Inspektori i Territorit**	Sistemi i Zbatimit të Ligjit për Ndërtimet; Sistemi i Mbrojtjes së Mjedisit; Sistemi i Kontrollit Administrativ.	3 v jet	I Mesëm
21	**Drejtoria e Administrimit të Pyjeve**	Sistemi i Menaxhimit dhe Planifikimit të Pyjeve; Sistemi i Menaxhimit të Kullotave; Sistemi i Kontrollit dhe Parandalimit të Zjarreve dhe Dëmtimeve; Sistemi i Shfrytëzimit dhe Procedurave të Prerjes së Pyjeve; Sistemi i Administrimit të Financave dhe të të Ardhurave; Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore	3 vjet	I Mesëm
22	**Gjendja Civile**	Sistemi i Regjistrimit të Ngjarjeve Civile; Sistemi i Arkivimit dhe Ruajtjes së Dokumentave; Sistemi i Shërbimit ndaj Publikut; Sistemi i Ruajtjes së të Dhënave	5 vjet	I Ulët
23	**Njësia Administrative Golaj**	Të gjitha sistemet;	5 vjet	I Ulët
24	**Njësia Administrative Fajza**	Të gjitha sistemet;	5 vjet	I Ulët
25	**Njësia Administrative Gjinaj**	Të gjitha sistemet;	5 vjet	I Ulët

***Adresa**: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

ORGANIGRAMA E BASHKISË HAS



***Adresa**: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

a) IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I RISQEVE

Plani strategjik i veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Has bazohet në një proces sistematik të identifikimit dhe vlerësimit të risqeve në të gjitha njësitë dhe sistemet e Bashkisë në përputhje me standartet globale të auditimit në sektorin publik. Qëllimi kryesor i këtij procesi është të sigurohet një kuadër i mirë - strukturuar për planifikimin tre - vjeçar të auditimeve, duke prioritarizuar njësitë dhe aktivitetet që paraqesin rrezik më të lartë për arritjen e objektivave strategjikë dhe menaxhimin financiar.

Subjektet dhe njësitë përkatëse janë kategorizuar sipas nivelit të riskut, duke përfshirë:

- Risk i lartë: Njësitë dhe sistemet që kanë ekspozim të konsiderueshëm ndaj mangësive në kontrollet e brendshme, keqmenaxhim financiar, ose mosrespektim të ligjit dhe procedurave;
- Risk mesatar: Njësitë dhe sistemet që prezantojnë disa dobësi në proceset e brendshme ose rreziqe potenciale që mund të ndikojnë në performancën e organizatës;
- Risk i ulët: Njësitë dhe sistemet që kanë kontrolle të mjaftueshme, por që kërkojnë vlerësim periodik për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm dhe monitorimin e zbatimit të procedurave.

Procesi i vlerësimit të riskut synon të:

- Përfshijë të gjitha risqet e rëndësishme, përfshirë ato të reja dhe në zhvillim, që mund të ndikojnë në objektivat e njësisë publike;
- Sigurojë një qasje afatmesme, duke mbuluar të gjithë periudhën strategjike 3 - vjeçare, jo vetëm vitin pasardhës;
- Vlerësojë të gjitha njësitë, strukturat, sistemet dhe fushat vepruese brenda bashkisë, në bazë të probabilitetit të ndodhjes dhe ndikimit të riskut;
- Klasifikojë fushat me risk të lartë për t'u audituar me frekuencë më të shpeshtë, me qëllim mbajtjen nën kontroll të ndryshimeve në nivelin e riskut dhe adresimin e risqeve në mënyrë prioritare;
- Ndihmojë në përcaktimin e prioriteteve të auditimit për çdo vit dhe në hartimin e një plani të qëndrueshëm që garanton përdorim efektiv të burimeve të NjAB.

Për çdo subjekt, është marrë parasysh:

- Frekuenca e auditimit (sipas nivelit të riskut dhe rregullit të mos tejkalimit të 5 viteve);
- Ndryshimet strukturore, ligjore apo financiare që ndikojnë në risk;
- Analiza e performancës dhe zbatimit të rekomandimeve të mëparshme.

Rezultati i këtij procesi ka çuar në përzgjedhjen e subjekteve të auditimit për vitet 2026, 2027 dhe 2028, të paraqitura në seksionin "Prioritetet për tre vitet".

Monitorimi dhe Rishikimi: Procesi i identifikimit dhe vlerësimit të risqeve do të monitorohet dhe rishikohet periodikisht për të reflektuar ndryshimet në objektivat strategjikë, zhvillimet ligjore dhe nevojat e menaxhimit, duke siguruar përshtatshmëri të vazhdueshme të planifikimit të auditimeve me prioritetet e Bashkisë Has.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

- **Qasja në Planifikimin Strategjik dhe Vjetor të Auditimit**

Planifikimi strategjik dhe vjetor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Has mbështetet në një proces të vazhdueshëm dhe të strukturuar të identifikimit dhe vlerësimit të risqeve. Ky proces kryhet të paktën një herë në vit dhe përfshin të gjitha subjektet që bëjnë pjesë në universin e auditimit.

Qëllimi kryesor është efektiviteti i angazhimeve të auditimit, bazuar në nivelin e riskut të vlerësuar për secilin sektor apo sistem të tij. Kjo garanton që të gjitha sistemet dhe subjektet me risk të lartë të auditohen çdo vit si dhe auditimet të planifikohen në mënyrë të balancuar për të menaxhuar në mënyrë optimale burimet dhe për të adresuar risqet më emergjente.

Përveç kësaj, gjatë përgatitjes së planit të auditimit, merret në konsideratë edhe inputi i menaxhmentit, përfshirë sugjerimet, opinionet dhe propozimet e dokumentuara. Këto janë krye-sisht të lidhura me angazhimet këshilluese, me qëllim:

- Përmirësimin e menaxhimit të risqeve,
- Shtimin e vlerës së ofruar nga Njësia e Auditimit të Brendshëm,
- Përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të veprimtarisë së institucionit të bashkisë.

Kjo qasje e integruar siguron që Plani Strategjik dhe ai Vjetor i auditimit janë të përshtatura me nevojat reale të institucionit dhe bazohen në një analizë të mirëfilltë të riskut dhe nevojave të menaxhimit.

b) KUFIZIMET E AUDITIMIT

Gjatë zbatimit të këtij plani, Njësia e Auditimit të Brendshëm mund të përballet me kufizime që ndikojnë në realizimin e objektivave të planifikuara. Këto kufizime përfshijnë burime të kufizuara njerëzore dhe kohore, mungesën e çertifikimeve të avancuara, akses të pamjaftueshëm në dokumentacion, si dhe ndryshime në legjislacion dhe politika të organizatës. Objekt i këtij plani mund të ketë kufizime të ndryshme për shkak të ndryshimeve strukturore të institucionit dhe ndryshimeve në legjislacion.

NJAB ka parashikuar masa për të menaxhuar këto kufizime, përfshirë planifikim të kujdesshëm të angazhimeve, koordinim të ngushtë me njësitë e audituara, përmirësim të vazhdueshëm të kapaciteteve të stafit dhe dokumentim të detajuar të procesit të auditimit. Këto masa synojnë të sigurojnë që kufizimet të mos cënojnë në mënyrë të konsiderueshme efektivitetin, pavarësisht sfidave të mundshme.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

Megjithatë, disa kufizime që pengojnë arritjen e objektivave të Njësisë së Auditimit të Brendshëm janë:

1. **Burimet njerëzore të kufizuara**, pasi NjAB ka vetëm dy specialistë dhe angazhimet e tjera mund të ndikojnë në përmbushjen e plotë të planit.
2. **Mungesa e certifikimeve të avancuara**, duke u mbështetur aktualisht në trajnime për zhvillim profesional, çka mund të ndikojë në kompleksitetin e disa angazhimeve.
3. **Akses i pamjaftueshëm në dokumentacion dhe sisteme**, përfshirë regjistrime elektronike ose dokumente të paplota nga njësitë e audituara.
4. **Ndryshimet në legjislacion ose rregulloret organizative**, që mund të kërkojnë përshtatje të metodologjive të auditimit dhe prioritetit të angazhimeve.
5. **Faktorë të jashtëm dhe bashkëpunim i kufizuar** nga njësitë e audituara, që mund të ndikojnë në kohëzgjatjen dhe cilësinë e angazhimeve të auditimit.

Për secilin prej këtyre kufizimeve, NjAB ka parashikuar masa për minimizim të ndikimit, duke përfshirë planifikim të kujdesshëm, koordinim të ngushtë me njësitë e audituara, dokumentim të plotë dhe përmirësim të vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale.

c) PRIORITET PËR TRE VITE (1+2)

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përcaktuar prioritetet kryesore për tre vitet e ardhshme, në funksion të përmirësimit të punës audituese dhe forcimit të kapaciteteve të funksionit të auditimit.

Këto prioritete përfshijnë:

- Përmirësimi i procesit të identifikimit dhe vlerësimit të riskut, për të siguruar se subjektet dhe fushat me risk më të lartë auditohet sipas planifikimit dhe në kohën e duhur.
- Forcimi i dokumentimit dhe gjurmueshmërisë së punës, duke përmirësuar regjistrimin elektronik dhe mbajtjen e dosjeve të plotë të auditimit.
- Zhvillimi profesional i stafit të auditimit dhe çertefikimi, përmes trajnimeve, pjesëmarrjes në seminare dhe ndjekjes së standardeve globale të auditimit.
- Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të auditimit, për të garantuar që masat korrigjuese të vendosura nga njësitë e audituara të implementohen në mënyrë efektive.
- Përshtatja e metodologjive dhe praktikave të auditimit, për t'u përputhur me ndryshimet ligjore dhe rregulloret organizative të Bashkisë Has.
- Rritja e bashkëpunimit me njësitë e audituara dhe aktorët e jashtëm, për të përmirësuar transparencën, raportimin dhe menaxhimin e riskut.
- Sigurimi i cilësisë së brendshme për kontrollin e punës së audituesve dhe rishikimin periodik të angazhimeve për të garantuar përputhshmëri me standardet profesionale.

Këto prioritete përbëjnë udhërrëfyesin kryesor të veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe shërbejnë si bazë për hartimin e planit vjetor të auditimit për çdo vit.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

- PRIORITETET PËR PERIUDHËN 2026 – 2028

Në funksion të vlerësimit të riskut, të objektivave strategjikë dhe të kapaciteteve të NjAB, për periudhën 2026–2028 janë përcaktuar si prioritete:

Auditimet e sigurimit - Të fokusuara në subjektet me risk të lartë dhe procese kyçe për funksionimin e bashkisë.

Angazhimet këshilluese - Për të mbështetur përmirësimin e proceseve të brendshme pa cënuar pavarësinë e NjAB.

Lloji i angazhimit	Përqindja e vlerësuar e burimeve vjetore
Auditime sigurimi	70%
Angazhime këshilluese	30%

- PLANIFIKIMI I AUDITIMEVE TË SIGURIMIT

VITI 2026 – Subjektet për Auditim

Nr.	Subjekti	Qëllimi i Auditimit
1	Auditimi i ndjekjes së Rekomandimeve të NJAB	Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të mëparshme.
2	Drejtoria e Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore	Detyrimet e prapambetura dhe përputhshmëria financiare.
3	Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore	Efikasiteti dhe ligjshmëria e shpërndarjes së ndihmës ekonomike.
4	Sektori Juridik dhe Prokurimet Publike	Ligjshmëria dhe transparenca në prokurimet publike.
5	Sektori i Planifikim Territorit dhe Urbanistikës	Kontrolli i lejeve dhe planifikimi urban.

VITI 2027 – Subjektet për Auditim

Nr.	Subjekti	Qëllimi i Auditimit
1	Auditimi i ndjekjes së Rekomandimeve të NJAB	Vlerësimi i progresit në implementimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm..
2	Drejtoria e Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore	Monitorimi i detyrimeve të prapambetura
3	Drejtoria e Administrimit të Pyjve	Menaxhimi dhe mbrojtja e burimeve natyrore.
4	Sektori i Zhvillimit Ekonomik	Efektiviteti i politikave për nxitjen e ekonomisë lokale.
5	Gjendja Civile	Cilësia dhe siguria e të dhënave të regjistrit civil.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

VITI 2028 – Subjektet për Auditim

Nr.	Subjekti	Qëllimi i Auditimit
1	Auditimi i ndjekjes së Rekomandimeve të NJAB	Vlerësimi përfundimtar i progresit 3-vjeçar.
2	Drejtoria e Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore	Analizë e debitorëve të akumuluar dhe rekomandime për përmirësime.
3	Sektori Juridik dhe Prokurimet Publike	Auditim i kontratave dhe dokumentave të tenderimeve, pagesat dhe afatet ligjore.
4	Drejtoria e Mbrojtjes Civile	Vlerësimi i planeve të emergjencës dhe reagimit.
5	Sektori i Tokës / Mbrojtjes së Konsumatorit	Procedurat për administrimin e tokës dhe të drejtave të qytetarëve.

- ANGAZHIMET KËSHILLUESE (2026–2028)

Qëllimi i këtyre angazhimeve është të mbështetet menaxhmenti për përmirësimin e proceseve administrative dhe kontrollit të brendshëm, pa cënuar pavarësinë e NJAB.

Angazhime të planifikuara ndër vite.

Viti	Subjekti / Fusha	Qëllimi i Këshillimit
2026	Sektori Juridik dhe Prokurimet Publike	Mbështetje në zbatimin e udhëzimeve ligjore dhe praktikave të mira në prokurime
2026	Drejtoria e Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore.	Ndihmë në përmirësimin e strukturës së raportimit të detyrimeve të prapambetura
2026	Sektori i Ndihmës Ekonomike	Mbështetje në zbatimin e udhëzimeve dhe kontrollit të përfituesve sipas legjislacionit në fuqi
2027	Administrimi i Pyjve	Mbështetje në përmirësimin e menaxhimit të burimeve natyrore.
2028	Drejtoria e Mbrojtjes Civile	Konsulencë në përmirësimin e planeve të reagimit në emergjenca
2028	Sektori i Tokës / Mbrojtja e Konsumatorit	Përmirësimi i procedurave të ankimimit dhe transparencës me qytetarët

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për periudhën 2025 - 2027

Nr.	SUBJEKTE PËR TU AUDITUAR	FUSHA PËR TU AUDITUAR	VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RISKUT		
			I LARTË	I MESËM	I ULËT
a.	1.	2.	3.	4.	5.
1	**Drejtoria e Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore**	Sistemi i pagave	X		
		Sistemi i debitorëve	X		
		Sistemi i pagesave për mallra dhe shërbime	X		
		Sistemi kryesor i llogarisë	X		
		Sistemi i kontrollit të të ardhurave dhe shpenzimeve	X		
		Sistemi i sigurimit dhe menaxhimit të riskut		X	
		Sistemi i shpenzimeve të kapitalit	X		
		Sistemi i inventarit (stokut)		X	
		Sistemi i menaxhimit të riskut		X	
		Sistemi i prokurimeve publike	X		
		Sistemi i menaxhimit buxhetor	X		
		Ruajtja e aseteve	X		
		Sistemi i kontabilitetit	X		
		Sistemi i Pasqyrave Financiare	X		
		Menaxhimi i buxhetit, arka, shpenzimet;	X		
		Llogaritja e pagave dhe listë-pagesat;		X	
		Kontabiliteti dhe pasqyrat financiare;	X		
		Magazinimi dhe administrimi i inventarit	X		
2	**Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore**	Sistemi i Tarifa të Shërbimeve Publike Vendore;	X		
		Sistemi i Arkëtimit të Detyrimeve;	X		
		Sistemi i Raportimit Financiar dhe Monitorimit;		X	
		Sistemi i Kadastrës Fiskale dhe Regjistrit të Taksapaguesve;	X		
		Sistemi i Administrimit të Taksave mbi Aktivitetet Ekonomike;	X		
3	**Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore**	Sistemi i ndihmës ekonomike;		X	
		Sistemi i Pagesës për Aftësi të Kufizuar (PAK);	X		
		Sistemi i Strehimit			X
		Sistemi i Përkujdesjes Shoqërore			X
		Sistemi i Ankesave dhe Komunikimit me Qytetarët;			X
		Sistemi Financiar dhe Raportimi			X

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

4	**Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës**	Sistemi i Hartimit të Dokumentave të Territorit;	X		
		Sistemi i Lëshimit të Lejeve të Ndërtimit;		X	
		Sistemi i Monitorimit dhe Kontrollit të Zbatimit;		X	
		Sistemi i Arkivimit të Dokumentacionit Teknik;		X	
		Sistemi i Platformave Elektronike;		X	
		Sistemi i administrimit të pronave;	X		
		Sistemi i komunikimit me ASHK;		X	
		Sistemi i të Dhënave;		X	
		Sistemi i Adresave;		X	
		Sistemi i Privatizimit	X		
5	**Sektori i Tokës/Mbrojtjes Konsumatorit**	Sistemi i regjistrimit dhe Administrimit të Tokës			X
		Sistemi i Monitorimit dhe Kontrollit të Përdorimit të Tokës			X
		Sistemi i Mbrojtjes së Tokës nga Eroziini dhe Degradimi			X
6	**Sektori i Burimeve Njerëzore**	Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore		X	
		Sistemi i HRMIS dhe Administrata.al		X	
		Sistemi i Komunikimit me Median		X	
		Sistemi i Arkivës		X	
		Sistemi i IT	X		
7	**Sektori Juridik**	Sistemi i Sektorit Juridik	X		
		Sistemi i Prokurimeve Publike	X		
		Sistemi i Protokollit		X	
		Sistemi i Koordinimit Evropian dhe Ndihmës së Huaj	X		
		Sistemi i Migracionit dhe Diasporës	X		
8	**Sektori i Zhvillimit Ekonomik**	Sistemi i zhvillimit ekonomik		X	
		Sistemi i turizmit		X	
		Sistemi i projekteve		X	
		Sistemi për promovimin e qytetit		X	
9	**Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sportit**	Administrimi i shkollave dhe kopshteve;		X	
		Sistemi i Inspektimit dhe Monitorimit të Arsimit;			X
		Sistemi i Menaxhimit të Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore;			X
		Biblioteka			X
10	**Sektori i Edukimi dhe Shërbimet në Konvikt**	Sistemi i Regjistrimit dhe Përfitimit të Shërbimit në Konvikt;			X
		Sistemi i Mirëmbajtjes dhe Infrastruktura;			X
		Sistemi i Aktiviteteve Edukative dhe Kujdesit Social			X

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

11	**Sektori i Turizmit dhe Sportit**	Sistemi i Zhvillimit dhe Promovimit të Turizmit;			X
		Sistemi i Mbrojtjes së Burimeve Turistike;			X
		Menaxhimi i Sportit dhe Infrastruktura Sportive			X
12	**Qendra Kulturore e Fëmijëve**	Sistemi i Regjistrimit dhe Përzgjedhjes së			X
		Fëmijëve; Sistemi i Kujdesit dhe Shërbimeve Edukative;			X
		Sistemi i Planifikimit dhe Organizimit të Aktivite-teve;			X
		Sistemi i Menaxhimit të të ardhurave dhe shpenzi-meve;			X
		Sistemi i Administrimit të Infrastrukturës dhe Paisjeve			X
13	**Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Komunale**	Shpenzimet për pastrimin, menaxhimi i punonjësve;		X	
		Mirëmbajtja e gjelbërimit, punonjësit sezonalë;			X
		Menaxhimi i mbetjeve, transporti dhe shpenzimet;		X	
		Mirëmbajtja e objekteve, ndriçimi, riparimet;		X	
14	**Sektori Rrugë - Kanalizime**	Sistemi i Ndërtimit,Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Rrugëve.		X	
		Sistemi i Kanalizimeve		X	
15	**Sektori Bordi i Kullimit**	Sistemi i Ndërtimit, Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Rrugëve;		X	
		Sistemi i Kanalizimeve		X	
16	**Drejtoria e Mbrojtjes Civile**	Sistemi i Planifikimit dhe Parandalimit të Emergjencave;	X		
		Sistemi i Monitorimit dhe Sinjalizimit të Rreziqeve;		X	
		Sistemi i Reagimit dhe Menaxhimit të Emergjencave;		X	
		Sistemi i Bashkëpunimit Ndërinstitucional;		X	
		Sistemi i Përdorimit dhe Mirëmbajtjes së Pajisjeve të Emergjencës;		X	
		Sistemi i Raportimit dhe Dokumentimit të Ngjarjeve		X	
17	**Sektori i Emergjencave Civile**	Sistemi i Planifikimit dhe Parandalimit të Emergjencave;		X	
		Sistemi i Monitorimit dhe Sinjalizimit të Rreziqeve;		X	
		Sistemi i Reagimit dhe Menaxhimit të Emergjencave;		X	
		Sistemi i Bashkëpunimit Ndërinstitucional;		X	
		Sistemi i Përdorimit dhe Mirëmbajtjes së Pajisjeve të Emergjencës;		X	
		Sistemi i Raportimit dhe Dokumentimit të Ngjarjeve		X	

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

18	Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi	Sistemi i Paisjeve, Mjeteve dhe Inventarit Teknik;		X	
		Sistemi i Trajnimeve dhe Gatishmëria e stafit;			X
		Sistemi i furnizimit dhe buxheti për MZSH;		X	
		Sistemi i Bashkëpunimit dhe Komunikimi me institucione tjera		X	
19	Policia Bashkiake	Sistemi i Inspektimeve dhe Kontrolleve në Terren;		X	
		Sistemi i Zbatimit të Masave Administrative;		X	
		Sistemi i Menaxhimit të Ankesave dhe Koordinimi i tyre.		X	
20	Inspektori i Territorit	Sistemi i Zbatimit të Ligjit për Ndërtimet;		X	
		Sistemi i Mbrojtjes së Mjedisit;		X	
		Sistemi i Kontrollit Administrativ.		X	
21	Drejtoria e Administrimit të Pyjeve	Sistemi i Menaxhimit dhe Planifikimit të Pyjeve;	X		
		Sistemi i Menaxhimit të Kullotave;		X	
		Sistemi i Kontrollit dhe Parandalimit të Zjarreve dhe Dëmtimeve;		X	
		Sistemi i Shfrytëzimit dhe Procedurave të Prerjes së Pyjeve;		X	
		Sistemi i Administrimit të Financave dhe të të Ardhurave;		X	
		Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore		X	
22	Gjendja Civile	Sistemi i Regjistrimit të Ngjarjeve Civile;			X
		Sistemi i Arkivimit dhe Ruajtjes së Dokumentave;			X
		Sistemi i Shërbimit ndaj Publikut;			X
		Sistemi i Ruajtjes së të Dhënave			X
23	Njësia Administrative Golaj	Të gjitha sistemet;			X
24	Njësia Administrative Fajza	Të gjitha sistemet;			X
25	Njësia Administrative Gjinaj	Të gjitha sistemet;			X

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Specialistë Auditimi i Brendshëm

Esmeralda Zyberaj

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM BASHKIA HAS

Plani Strategjik i subjekteve për tu audituar për vitet 2026 - 2028

Nr	SUBJEKTE PËR T'U AUDITUAR SIPAS VITEVE					
	VITI I PLANIFIKUAR 2026	NIVELI I RISKUT	VITI I PLANIFIKUAR +1 2027	NIVELI I RISKUT	VITI I PLANIFIKUAR +2 2028	NIVELI I RISKUT
a	1	2	3	4	5	6
1	Auditimi i ndjekjes së zbatimit të Rekomandimeve të NJAB	I Lartë				
2	Drejtoria e Financës,Taksave dhe Tarifave Vendore (Detyrimet e Prapambetura)	I Lartë				
3	Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore	I Ulët				
4	Sektori Juridik dhe Prokurimet Publike	I Lartw				
5	Sektori i Planifikim Territorit dhe Urbanistikës	I Mesëm				
6			Auditimi i ndjekjes së zbatimit të Rekomandimeve të NJAB	I Lartë		
7			Drejtoria e Financës,Taksave dhe Tarifave Vendore(Detyrimet e Prapambetura)	I Lartë		
8			Drejtoria e Administrimit të Pyjve	I Mesëm		
9			SektoriiZhvillimit Ekonomik	I Mesëm		
10			Gjendja Civile	I Ulët		
11					Auditimi i ndjekjes së zbatimit të Rekomandimeve të NJAB	I Lartë

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

12					Drejtoria e Financës,Taksave dhe Tarifave Vendore (Detyrimet e Prapambetura)	I Lartë
13					Sektori Juridik dhe Prokurimet Publike	I Lartë
14					Drejtoria e Mbrojtjes Civile	I Mesëm
15					Sektori i Tokës/Mbrojtjes Konsumatorit	I Ulët

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Specialiste Auditimi i Brendshëm

Esmeralda Zyberaj

***Adresa**: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

PLANI VJETOR PËR VEPRIMTARINË E NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM, BASHKIA HAS, VITI 2026

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

STRUKTURA E PLANIT VJETOR

I. ZHVILLIMET AKTUALE TË NJAB.....21
II. PRIORITETET E AUDITIMIT PËR VITIN 2025.....22
III. OBJEKTIVAT KRYESORE PËR VITIN E ARDHSHËM.....23
IV. PROGRAMIMI I LLOJIT TË ANGAZHIMEVE.....23
V. PLANIFIKIMI I KOSTOS PËR VITIN E PARË 2025.....24
VI. PLANIFIKIMI I BURIMEVE PËR VITIN 2025.....25
VII. PLANIFIKIMI I NEVOJAVE TË STAFIT PËR TRAJNIM.....26
VIII. SIGURIMI I BRENDSHËM I CILËSISË.....27

TABELA E PASQYRAVE

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

I. ZHVILLIMET AKTUALE TË NËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM.

Bashkia Has është njësi vendore ku misioni i saj është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëvë, duke garantuar vetëqeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore. Bashkia Has ushtron veprimtarinë e saj në mbështetje të ligjit nr. 139/ 2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" në RSH.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Has nuk është formuar me strukturë të plotë megjithëse zhvillon veprimtarinë e saj në bazë të ligjit nr. 114 datë 22.10.2015 (i ndryshuar).

Aktualisht në strukturë janë të miratura 3 punonjës në Njësinë e Auditit (1 Përgjegjës dhe 2 Specialistë) mirëpo veprimtaria e auditimit të brendshëm kryhet nga 1 specialist auditimi i brendshëm.

Sektori i auditimit të brendshëm ushtron aktivitetin e saj në zbatim të Ligjit nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" (i ndryshuar) dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore me synimin e vetëm për rritje ekonomike, angazhim dhe cilësi maksimale në shërbimet publike të ofruara.

Plani Vjetor mund të rishikohet rregullisht gjatë vitit dhe të azhornohet sipas nevojës, në mënyrë që t'i pasqyrojë ndryshimet e rëndësishme që ndodhin në Bashkinë Has apo tek anëtarët e njësisë së Auditimit të Brendshëm, dhe çdo detyrë shtesë të propozuar nga Kryetari i Bashkisë. Ndryshimi i Planit Vjetor miratohet nga Kryetari i Bashkisë, firmoset nga personat përgjegjës të njësisë së auditimit të brendshëm dhe dërgohet në Ministrinë e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Kontrollit të Brendshëm Financiar, Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Zhvillimet aktuale të NJAB:

Gjatë vitit 2025, Njësia e Auditimit të Brendshëm po vazhdon veprimtarinë e saj në zbatim të programit të miratuar vjetor të auditimit. Deri në këtë fazë të vitit janë realizuar auditime, në përputhje me planin dhe objektivat e përcaktuara.

Aktualisht, njësia përbëhet nga një specialist auditimi, për shkak të largimit nga puna të audituesit tjetër. Pavarësisht kufizimeve në burime njerëzore, po bëhen përpjekje për të siguruar vazhdimësinë e punës dhe për të ruajtur cilësinë e auditimeve, duke u fokusuar në çështje me rrezik më të lartë dhe në ndjekjen e rekomandimeve të dhëna në auditimet e mëparshme.

Në këtë kuadër, NJAB mbetet e angazhuar në forcimin e funksionit të auditimit të brendshëm dhe në rritjen e vlerës së shtuar për institucionin, përmes identifikimit të dobësive në sistemet e kontrollit të brendshëm dhe dhënies së rekomandimeve për përmirësim të vazhdueshëm.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

Metodologjitë dhe aktivitetet mbështetëse:

NJAB do të përdorë metodologji të standardizuara dhe të dokumentuara për të udhëhequr funksionin e auditimit të brendshëm dhe për të realizuar objektivat strategjikë dhe planin vjetor të auditimit. Kjo përfshin:

1. **Vlerësimin e rrezikut** – identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve për organizatën dhe për çdo angazhim të veçantë auditimi, për të përcaktuar prioritetet.
2. **Zhvillimin dhe përditësimin e planit të auditimit** – programimin e angazhimeve sipas prioritetit, burimeve të disponueshme dhe nevojave të stafit për trajnim.
3. **Monitorimin e rekomandimeve** – ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e mëparshme dhe raportimin periodik pranë menaxhmentit.
4. **Dokumentimin dhe gjurmueshmërinë** – sigurimin që çdo angazhim të dokumentohet plotësisht, dosjet të jenë të organizuara dhe të ruajtura sipas standardeve të auditimit të brendshëm.
5. **Sigurimin e cilësisë** – vlerësimin periodik të cilësisë së auditimit dhe të proceseve të brendshme, duke përfshirë kontrollin mbi zbatimin e metodologjive.
6. **Përshtatshmëria ndaj ndryshimeve** – rishikimin e planit dhe metodologjisë në rast ndryshimesh në objektivat strategjikë, politikat dhe procedurat e organizatës, ose në menaxhimin e rrezikut dhe kontrollit.
7. **Trajnimi dhe zhvillimi i stafit** – mbështetjen e zhvillimit profesional të audituesve të brendshëm, përfshirë trajnime, ndjekjen e kurseve dhe certifikimeve të nevojshme për rritjen e kapaciteteve të njësisë.

Kjo qasje siguron një funksion auditimi të brendshëm të efektshëm, të gjurmueshëm dhe në përputhje me standardet e brendshme dhe rregulloret ligjore në fuqi.

II. PRIORITETET E AUDITIMIT PËR VITIN 2025.

Për vitin 2026 Sektori i Auditimit të Brendshëm, Bashkia Has ka si prioritet të rrisë nivelin e kontrollit të brendshëm dhe të sigurojë një njohje të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë e vartësisë, drejtori dhe sektorë të Bashkisë për menaxhimin më të mirë të aktivitetit të institucionit dhe realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve. Prioritetet jane bazuar në anlizën e rreziqeve, ndryshimet në strukurën organizative të bashkisë, objektivat strategjikë të bashkisë si dhe nevojat e sektorëve përkatës.
Këto prioritete përfshijnë:

- Zbatimi i rekomanimeve të kaluara të auditimit të brendshëm ku do realizohet % e zbatimit të rekomandimeve që janë dhënë nga auditimi i brendshëm.
- Analiza e rrezikut - Vlerësimi i rrezikut duke përcaktuar fushat më ndikimin më të madh financiar dhe ligjor si dhe përzgjedhja e proceseve dhe aktiviteteve të cilat kërkojnë vëmendje më të madhe për të siguruar përdorimin efikas të burimeve të auditimit të brendshëm dhe për të shtuar vlerën për Bashkinë Has.
- Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm - Funksionimi dhe efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm në Bashkinë Has si dhe identifikimi i mangësive në procedura, sigurimi i zbatimit të ligjeve dhe rrgulloreve në fuqi si dhe garantimi i përdorimt më efikasitet, ekonomi dhe efiçencë të burimeve publike.
- Ndjekja e trajnimeve dhe zhvillimit profesional të punonjësve të Njësisë së Auditimit të

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

Brendshëm si dhe rritja e kualifikimit përmes trajnimeve në fushën e procedurave, metodave, teknikave të auditimit si dhe teknikave mbi vlerësimin e riskut.

- Rritja e cilësisë dhe performancës së auditimeve duke shtuar cilësinë e zbulimeve dhe rekomandimeve me qëllim dhënien e impaktit në rritje përsa i përket përmirësimit të menaxhimit dhe shtimit të vlerës.

III. OBJEKTIVAT KRYESORE PËR VITIN E ARDHSHËM.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në ushtrimin e veprimtarisë së tij të pavarur synon që subjektet e audituara në Bashkinë Has të përmbushin disa objektiva.

1) Forcimi i Sistemit të Kontrollit të Brendshëm duke siguruar që strukturat, procedurat dhe politikat e Bashkisë funksionojnë në mënyrë efektive për të parandaluar gabimet, mashtrimet dhe keqpërdorimet.
2) Vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve duke identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar rreziqet që mund të pengojnë arritjen e objektivave strategjike dhe operacionale.
3) Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në publikimin e informacionit të qartë, të saktë për qytetarët dhe aktorët e interesit, në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë.
4) Përmirësimi i menaxhimit financiar dhe burimeve në përdorimin sa më të mirë të burimeve financiare dhe njerëzore, duke identifikuar mundësi për kursime ose efikasitet.
5) Ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve për përmirësim në bazë të rekomandimeve nga auditimet e brendshme dhe të jashtme.
6) Mbështetjen për përdorimin efikas dhe efektiv të fondeve publike.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka si mision të tij të ndihmojë bashkinë të arrijë objektivat e veta duke përmirësuar proceset, transparencën dhe kontrollin.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Has ka si objektiv kryesor të sigurojë pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret, të vlerësojë dhe përmirësojë sistemin e kontrollit të brendshëm, dhe të ndihmojë menaxhimin në menaxhimin e rreziqeve për të garantuar përdorimin efikas dhe efektiv të burimeve publike. Gjithashtu, NJAB promovon transparencën dhe llogaridhënien, ndjek zbatimin e rekomandimeve dhe mbështet arritjen e objektivave strategjike të bashkisë, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve dhe shërbimeve për komunitetin.

Adresa: *Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

I. PROGRAMIMI I LLOJIT TË ANGAZHIMEVE.

Për vitin 2026 janë planifikuar të kryhen 5 angazhime auditimi.

Nr.	Bashkia Has	Fusha e Auditimit	Numri i Auditimit	Lloji i Angazhimit
1	***Auditimi i ndjekjes së zbatimit të Rekomandimeve të NJAB***	Vlerësimin e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm; Identifikimin e rekomandimeve të zbatuara, pjesërisht të zbatuara ose të pazbatuara dhe analizën e arsyeve që kanë penguar zbatimin e plotë; Vlerësimin e efektivitetit të masave të marra; Përputhshmërinë e veprimeve të institucionit me legjislacionin në fuqi; Ekzistencën dhe funksionimin e mekanizmave të brendshëm të monitorimit; Vlerësimin e ndikimit të moszbatimit të rekomandimeve; Identifikimin e rreziqeve të mundshme, që lidhen me mungesën e zbatimit të rekomandimeve.	1	*Përputhshmëri*
2	***Drejtoria e Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore (Detyrimet e Prapambetura)***	Shkallën e detyrimeve financiare **të institucionit;** Arsyet e prapambetjes në shlyerjen e detyrimeve**;** Mangësitë në menaxhimin financiar; Menaxhimin e të ardhurave; Përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullator; Ndikimin e detyrimeve në ofrimin e shërbimeve publike; Ndikimin në besueshmërinë e administratës publike; Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve që lidhen me detyrimet, si: Procedura ligjore nga palë të treta (padi, procese gjyqësore); Penalitete financiare për vonesa në pagesa; Ndëshkime ligjore apo kontraktuale që cënojnë integritetin dhe funksionimin e institucionit të Bashkisë.	1	*Financiar*
3	***Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore;***	Zbatimin e politikave dhe programeve të ndihmës ekonomike dhe përkujdesjes shoqërore; Procesin e përzgjedhjes dhe verifikimit të përfituesve; Menaxhimin dhe shpërndarjen e fondeve të alokuara për ndihmë ekonomike dhe shërbime sociale; Funksionimin e strukturave përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale**;** Mbështetjen e kategorive në nevojë, si familjet me ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, fëmijët pa përkujdesje prindërore; Identifikimin e mangësive në menaxhim dhe kontroll; Vlerësimin e ndikimit të shërbimeve të		*Përputhshmëri*

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

		përkujdesjes shoqërore;		
4	***Sektori Juridik dhe Prokurimet Publike.***	Vlerësimin e funksionimit të sektorit juridik; Evidentimin dhe ndjekjen e çështjeve gjyqësore; Përputhshmëria ligjore e veprimtarisë administrative; Planifikimin, zhvillimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit publik në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për prokurimet publike dhe me parimet e transparencës, konkurrencës dhe efikasitetit; Hartimi dhe zbatimi i kontratave; Menaxhimin e dosjeve të prokurimeve publike; Identifikimin e mangësive dhe rreziqeve në proceset ligjore dhe të prokurimit, si vonesa proceduriale, mungesë dokumentacioni, konflikte interesi, keqpërdorim i fondeve apo penalitete ndaj institucionit.		*Përputhshmëri*
5	***Sektori i Planifikim Territorit dhe Urbanistikës.***	Hartimin dhe zbatimin e planeve vendore të zhvillimit të territorit; Procedurat për dhënien e lejeve të ndërtimit dhe miratimin e projekteve urbanistike; Funksionimin e strukturave përgjegjëse për planifikimin urban; Mbikëqyrjen e zbatimit në terren të lejeve të ndërtimit, duke verifikuar nëse ndërtimet realizohen sipas kushteve të lejuara dhe në përputhje me planet urbanistike. Menaxhimin e dokumentacionit urbanistik; Identifikimin e rreziqeve që lidhen me planifikimin dhe kontrollin territorial.		*Përputhshmëri*

Në përputhje me analizën e situatës aktuale në Bashkinë tonë, menaxhimi i fondeve IPA dhe fondeve të tjera financiare nga Bashkimi Evropian, si dhe zbatimi i Marrëveshjes së Facilitetit, nuk janë të pranishme në strukturat institucionale dhe nuk ka asnjë marrëveshje në fuqi lidhur me këto fonde gjatë periudhës së auditimit për vitin 2025.

Për këtë arsye, këto auditime nuk janë përfshirë në programin vjetor të auditimit, duke qenë se auditimi i këtyre fushave nuk është i aplikueshëm në kontekstin aktual të institucionit.

Kjo qasje siguron përqendrimin e burimeve të auditimit në fushat e prioritetit dhe rrezikut real të institucionit, duke garantuar efikasitet dhe efektivitet në realizimin e objektivave të auditimit.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

II. PLANIFIKIMI I KOSTOS PËR VITIN E PARË 2026.

Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Has sipas strukturës organizative e miratuar, e ndryshuar nga Titullari i Bashkisë me VKB me nr. 581 prot, datë 22.06.2023 përbëhet nga 1 Përgjegjës dhe 2 specialistë auditi.

Përllogaritja e kostos së auditimit është bazuar në:

- Pagën bruto dhe kontributet për sigurime shoqërore për stafin e NJAB;
- Shpenzimet për udhëtime zyrtare, dieta dhe trajnimet profesionale të audituesve;
- Shpenzime të tjera operative të nevojshme për funksionimin e njësisë (materiale zyre, pajisje, teknologji, etj.);
- Numri i punonjësve dhe kostoja e planifikuar për person;
- Vlerësimi i burimeve financiare të nevojshme për zbatimin e planit të auditimit të vitit, të cilat të gjitha së bashku përbëjnë koston e auditimit.

Në bazë të llogaritjes kosto për person për vitin 2026 gjendet e llogaritur ne Pasqyren nr. 5 tek Planifikimi i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2026.

III. PLANIFIKIMI I BURIMEVE PËR VITIN 2026.

Plani vjetor dhe plani strategjik për periudhën 2026 - 2028 është përgatitur mbi bazën e burimeve njerëzore aktuale në dispozicion. Llogaritja është kryer bazuar në ditët e punës të vlefshme në vit, pa përfshirë pushimet vjetore dhe festat zyrtare si dhe bazuar në njerëz audites që janë në stafin e njësisë së auditimit për vitin 2026.

Nga koha efektive e punës në ditë/njerëz, janë zbritur ditë/njerëz që nevojiten për pushimet vjetore, festat zyrtare, pushimet javore, pushime për arsye shëndetësore, trajnime dhe angazhime të tjera si takime, mbledhje etj. Gjithashtu është marrë në konsideratë dhe kompleksiteti i një fushe llogarie, apo sistemi të cilat kërkojnë më tepër kohë. Referuar këtyre treguesve garantohet realizimi i planit të auditimeve për vitin 2026.

Në rast ndryshimeve të strukturës organizative, plani vjetor i strukturës së Auditit të Brendshëm do të rishikohet për t'u përshtatur me kërkesat e reja të Bashkisë dhe cdo ndryshim do raportohet në Drejtrinë e Harmonizimit të Auditimit te Brendshëm, Ministria e Financave.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

IV. PLANIFIKIMI I NEVOJAVE TË STAFIT PËR TRAJNIM.

Për realizimin e misionit të auditimit një rol shumë të rëndësishëm luan dhe përmirësimi i kapacitetëve njerëzore në Njësinë të Auditimit në Bashki. Aktualisht Njësia e Auditit të Brendshëm funksionon me 2 (dy) specialistë. Eshtë shumë e rëndësishme të shtohet numri dhe të ndryshohet struktura e njësisë së auditimit të brendshëm.

Gjithashtu mbështetur në Ligjin 114/ 2015 "Për Auditimin e Brendshëm", neni 20 dhe neni 23 për trajnimin e vijueshëm profesional si pjesë përbërëse e planit strategjik dhe vjetor është parashikimi dhe përcaktimi i nevojave për trajnime.

Nevojat për trajnim të auditit janë thelbësore për të siguruar që auditorët të kenë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të kryer auditime efektive.

Disa nga nevojat kryesore për trajnim përfshijnë:

1. Rëndësia e Menaxhimit të Riskut dhe Kontrollit për funksionin e auditimit të brendshëm;
2. Planifikimi i veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik;
3. Kuptimi i Standardeve Globale për Auditimin e Brendshëm dhe praktikës së zbatimit në sektorin publik;
4. Kontrolli dhe Auditimi i Financave Publike;
5. Raportimi dhe Monitorimi i Rekomandimeve të Auditimit të Brendshëm;
6. Auditimi i Fondeve IPA dhe Financimeve të Bashkimit Evropian: Vlerësimi i Përshtatshmërisë dhe Efektivitetit të Sistemeve të Menaxhimit;
7. Shërbimi Këshillimor dhe roli i audituesit në organizata publike;
8. Teknologjitë e Informacionit dhe sistemet elektronike në auditim:
9. Etika dhe Integriteti në Auditimin e Bashkisë;
10. Shërbimi këshillimor dhe roli i Audituesit të Brendshëm.

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

V. SIGURIMI I BRENDSHËM I CILËSISË.

Planifikimi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë nga Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) është një detyrë themelore për të siguruar që veprimtaria e auditimit kryhet në përputhje me standardet profesionale dhe që cilësia e punës rritet në mënyrë të qëndrueshme.

Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me qëllimin e krijimit të shërbimit të auditimit të brendshëm si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe Standardet.

Programi i sigurimit të cilësisë , vlerëson efikasitetin, efektivitetin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. si dhe identifikon mundësitë për përmirësim.

Drejtuesit e njësive së auditimit të brendshëm janë përgjegjës për të përcaktuar se nga kush dhe në çfarë niveli, duhet të kryhet monitorimi i angazhimit të auditimit të brendshëm.

Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë të veprimtarisë së auditimit të brendshëm fillon me vlerësimet e brendshme të cilësisë me përcaktimin nëse politikat dhe procedurat e aplikueshme janë krijuar dhe zbatuar për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet dhe kodin e etikës. Sigurimi i cilësisë që kryhet nga Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm të cilët janë përgjegjës për të përcaktuar se nga kush dhe në çfarë niveli, duhet të kryhet monitorimi i angazhimit të auditimit të brendshëm kjo sipas procedurave të përcaktuara në Kapitullin VII "Sigurimi i cilësisë së punës së auditimit të brendshëm" në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Bashkëngjitur japim informacion lidhur me aktivitetin e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2025, si dhe planifikimin strategjik për vitet 2026 – 2028.

Formati standard 1: Pyetësor vlerësimi për mjedisin e kontrollit të brendshëm
Formati Standard 2 – Pyetësori për Planin Strategjik – Të kuptosh procedurat e Auditimit të Brendshëm
Pasqyra Nr.1: Vlerësimi i nivelit të risqeve për të gjithë subjektet që do të auditohen nga NJAB
Pasqyra Nr. 2: Plani strategjik i subjekteve të synuara për t'u audituar për vitet 2026 - 2028
Pasqyra Nr.3 : Plani i angazhimeve të NjAB për vitin 2026
Pasqyra Nr. 4: Plani i nevojave për trajnim të NjAB për vitin 2026
Pasqyra Nr.5: Planifikimi i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NjAB për vitin 2026.

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM
Specialistë Auditimi i Brendshëm
Esmeralda Zyberaj

KRYETAR
Miftar DAUTI

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al